



TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Qershor 2022

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000

Komisionet dhe Tarifat

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	0%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Referojuni prospektit te fondit
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.25% per vitin 2021
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emtuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.


Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.25% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2021. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Prestigj është në kategorinë e dytë të Profilit të Rrezikut dhe Perfitimit.


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30.06.2022

Vlera Neto e Aseteve	44,042,448,824
Numri i investitoreve	29,322
Çmimi i Kuotes	1,567.6598
*Kthimi vjetor neto nga investimi (30.06.2021 – 30.06.2022)	0.14%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 30 Qershor 2022



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Prestigj, investimet do të kryhen kryesisht në bono dhe obligacione thesari, të emtuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar apo transaksioneve në tregun sekondar. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një herë në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti

Instrumenti	Ne % te Aseteve te Fondit
Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	4.11%
Depozita & Llogari rrjedhese	6.88%
Bono Thesari	26.07%
Obligacione Thesari	62.94%

Strategjia e investimeve është e fokusuar në tituj të Qeverisë Shqiptare, por përveç këtyre investimeve, Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 44.04 miliardë në datë 30 Qershor 2022.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Qershor


Ekonomia Shqiptare nuk bën përjashtim nga ekonomitë e vendeve të tjera të rajonit, ajo është prekur nga pasojat që ka shkaktuar konflikti në Ukrainë, i cili ka rritur çmimet e produkteve dhe inflacionin në gjithë botën. Norma e inflacionit arriti në 6.7% në muajin Maj dhe sipas parashikimeve të Bankës së Shqipërisë, inflacioni në Shqipëri pritet të mbetet në nivelet 5-6% për pjesën e mbetur të vitit. Rritja e normës bazë të interesit me 0.5% nga ana e Bankës Qendrore në muajin Mars është pasuar nga rritja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Qeverisë Shqiptare në të cilat Fondi Prestigj investon. Banka e Shqipërisë pritet të pasojë me rritje të tjera normash (ndoshta 2 rritje nga 25 pikë deri në fund të vitit) për ta kthyer inflacionin përsëri në nivelin e synuar prej 3%.

Asetet e Fondit Prestigj janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye Fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve.

Pergjate muajit Qershor në tregun vendas, normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare vazhduan të kenë një trend rrites. Yieldi i Bonos të Thesarit 12-mujore rezultoi në 2.505% duke u rritur me 22 pikë në krahasim me ankandin e muajit Maj, ndërsa Bonoja e Thesarit 3-mujore u rrit me 25 pikë.

Per sa i perket obligacioneve, ankandi i obligacionit 2 vjeçar-i rezultoi në 2.90%, duke u rritur me 0.16% në krahasim me normën e ankandit paraardhës. Ankandi i obligacionit referencë 3-vjeçar rezultoi në 3.674%, duke u rritur me 40 pikë krahasuar me ankandin e fundit të muajit Prill. Gjithashtu u zhvillua edhe ankandi i obligacionit 7 vjeçar i cili rezultoi në 5.00%, duke u rritur me 0.77% krahasuar me ankandin e fundit të muajit Mars.

Grafiku me poshte jep një pasqyre të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Qershor 2021 – Qershor 2022. Për obligacionet referencë 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yields fikse të perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Qershor.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Qershor 2022

Kthimi vjetor neto për periudhën 30 Qershor 2021 – 30 Qershor 2022 është **0.14%**.

Çmimi i kuotës së fondit Prestigj në muajin Qershor ka pësuar një rënie me **-0.28%**, si pasojë e rritjes së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të emetuara nga Qeveria Shqiptare. Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut, sic janë ndryshimet e normave të interesit të titujve të borxhit të emetuar nga Qeveria Shqiptare.

Kështu kur normat e interesit në treg rriten, vlera e titujve të portofolit ulet dhe për rrjedhojë ulet dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen. Për pasojë, çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm. Luhatshmeria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi i saj është i pamundur, kështu çmimi i kuotës mund edhe të bjere, jo vetëm të rritet.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Prestigj



Ne dt 30 Qershor 2022	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	8 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (1 Mars 2012)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	0.14%	1.17%	1.08%	1.91%	3.40%	3.64%	4.45%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Prestigj per çdo vit



Investitorët e fondit Prestigj dhe të gjithë fondëve të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga konflikti gjeopolitik dhe rritja e inflacionit, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Të dhënat për kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtime apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit.

Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sh.a., në website www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.

